

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 7.2.2013**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1457, DATË 28.7.2009 “PËR  
PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË  
KRYEJNË VEPRIMTARI TË FORMIMIT PROFESIONAL”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 8 dhe nenit 23 shkronja “c” të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 5 kreu II dhe pikës 4 kreu XI të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave

**UDHËZOJ:**

1. Përmbajtja e pikës 3 të udhëzimit nr. 1457, datë 28.7.2009 “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional”, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit:

1. Shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, i cili përfshin dokumentet provuese sipas aneksit 1 fusha X kategoria X.2.B, bashkëngjitur vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave dhe dokumentet provuese që lidhen me drejtuesin teknik, sipas përcaktimit të germës “a” pika 4 kreu III të këtij vendimi.

2. Bën inspektimin në vend të shërbimit që ofron subjekti, inspektim, i cili konsiston në plotësimin e standardeve lidhur me:

a) Përshtatshmërinë e ambientit

Sipërfaqja minimale për çdo vend pune/kursant të jetë 3-5 m<sup>2</sup> (në funksion të specialitetit të kursit), të ekzistojë baza materiale e nevojshme dhe kushtet higjieno-sanitare të përshtatshme.

b) Aftësitë teknike të instruktorit

Instruktori të ketë diplomë ose certifikatë për profesionin që do të ofrojë, nivel arsimor të paktën të mesëm, si dhe eksperiencë pune minimalisht 5 vjet, në profesionin për të cilin ofrohet formimi.

c) Përshtatshmërinë e programit të trajnimit

Programi i trajnimit të jetë i detajuar në orë, me module të veçanta, ku të jetë përcaktuar qartë raporti teori/praktikë.

d) Dokumentacionin e plotësuar për kursantin, i cili përfshin:

i) Librin e amzës, me numrin përkatës për çdo kursant;

ii) Regjistrin mësimor;

iii) Mandate arkëtimi për pagesën e kursit.

e) Pajisjen e kursantit me certifikatën përkatëse pas përfundimit të kursit.

Certifikata duhet të ketë këto elemente të domosdoshme:

- Emërtimi (certifikatë);

- Nr. amze (referuar librit të amzës);

- Emri i subjektit sipas emërimit në licencën e QKL-së;

- Foto e kursantit e prekur nga vula e subjektit;

- Teksti të përmbajës të dhënave të shënuara në librin e amzës;

- Numri i plotë i licencës dhe data e licencimit, dhënë nga QKL-ja;

- Emri i administratorit, firma dhe vula e subjektit.

2. Në rreshtin e dytë të pikës 16, pas fjalës “e kërkuara” të shtohet togfjalëshi “në pikën 3 të këtij udhëzimi”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE  
SHANSEVE TË BARABARTA  
**Spiro Ksera**